



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilimjen / Prodato Received / Delivery	17-03-2023	3 viti god yngj	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shitja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM-BAICK	2790/2023		119



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.326/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabni-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.326/2023 të datës 07.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike "kontestim konkursi", në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 17.03.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.326/2023 të datës 07.02.2023, të parashtruar nga ankuesja.

**A r s y e t i m**

Ankuesja më datë 07.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1499/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.90/2023 të datës 16.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë lidhur me refuzimin e aplikacionit për grupin e pozitës Specialistë të Shkencave Shoqërore-Inspektor i Arsimit, në Inspektoratin e Arsimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa kjo e fundit me datë 15.03.2023 ka dërguar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 1499/2023 të datës 07.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ankesën e ankueses (pa datë dhe numër) drejtuar Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Vendimin me Nr.90/2023 të datës

16.01.2023; Vendimin me Nr.70/2023 të datës 06.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1858/2023 të datës 16.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 266/2023 të datës 15.03.2023; Konkursin me numër të referencës RN00010341 të datës 02.11.2022; Aplikacionin e datës 29.11.2022 tw ankueses; Diplomën universitare me Nr.429 të datës 13.02.2017; Certifikatën e muajit Maj 2022 të lëshuar nga Drejtori i Departamentit për Arsim Parauniversitar MASHT; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në programin e trajnimit "Aplikimi i programeve online në sigurimin e cilësisë në mësimdhënie"; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit Teaching Grammar Communicatively"; Certifikatën për pjesëmarrje dhe përfundim tw suksesshëm në trajnimin "Programi për Zhvillimin Profesional për Koordinator të cilësisë"; Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të kursit të gjuhës angleze; Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të programit në trajnimin "Vlerësimi i Performancës së Shkollës" Prishtinë 2008; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit për drejtor të shkollave për "Mjediset Mësimore Mike për Fëmije: Certifikatën për pjesëmarrje dhe përfundim të trajnimit "Për fushën nw Gjuhwt dhe Komunikimi në Zbatimin e Kurrikules se Re" Prishtinë 2017; Certifikatën e datws 05.02.2017 lidhur me përfundimin me sukses tw trajnimit SITOS-ADMIN"; Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses tw trajnimit 20 ore të kursit themelor "Vlerësimi për Nxënie" të përfunduar nw Dhjetor 2015; Certifikatën lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze" në vitin 2019; Certifikatën lidhur me përfundimin e kursit "Critical Thinkin in Language Larning and Teaching" të mbajtur në periudhën kohore 22.06.2015 deri me 28.08.2015; Certifikatën e datës 19.07.2015 lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit për gjuhen angleze; Certifikatën e datës 17.05.2014 lidhur me përfundimin me sukses në trajnimin "Teaching English to Young Learners" ; Certifikatën pa datë dhe numër; Certifikatën e datës 22.04.2011; Certifikatën e datës 21.11.2007; Certifikatën e datës 21.11.2007; Certifikatën lidhur me përfundimin e 20 orëve të kursit "Standardet dhe fasilimit të nxënit" të lëshuar në Dhjetor 2015; Kontratën e punës për marrëdhënie në kohë të pacaktuar me numër 434 të 01.09.2019; Shkresën e datës 28.06.2021; Shkresën e datës 22.04.2011; Dokumentin e identifikimit; Shkresën lidhur me vlerësimin e performancës se mësimdhënësit (pa datw dhe numër); Deklaratën e datës 29.11.2022; CV e ankueses; Certifikatën nën shenjen PN.NR.Kr.Br.8172/22 të datës 17.11.2022 nga evidenca e personave kundër të cilës nuk është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave te dënuar nga kjo gjykatë; Emalin e datës 10.01.2023 të M.Kryeziu drejtuar A.Kameraj; Vendimin me numër A.nr.399/2023 të datës 15.03.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e-mailin e datës 27.02.2023 nga për dhe 03.03.2023 të për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, konstatoi që të përfundoj procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.326/2023 të datës 07.02.2023, *sepse:*

Nga shqyrtimi i provave të çështjes, Kolegji ka konstatuar së Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 02.11.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm me numër reference RN00010341 për grupin e pozitës *Specialist i Shkencave Shoqërore/ Inspektor i Arsimit*, në Inspektoratin e Arsimit, i hapur për aplikim nga data 23.11.2022 deri me datë 07.12.2022. Në konkursin në fjalë kishte aplikuar edhe ankuesja, mirëpo në fazën e shqyrtimit paraprak, Njësia Përgjegjëse/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin Nr.70/2023 të datës 06.01.2023 ka refuzuar aplikacionin e ankueses për shkak se e njëjta nuk ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas konkursit respektivisht dëshminë /vet

dekorimin se nuk ka masë disiplinore në dosjen personale dhe dëshminë lidhur me përvojën e punës.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së ankuesja me datë 10.01.2023, ka paraqitur ankesë kundër Vendimit Nr.70/2023 të datës 06.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa ky i fundit me Vendimin Nr.90/2023 të datës 16.01.2023, ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar, po me arsyetimin së ankuesja nuk ka dorëzuar dokumentet e kërkuara sipas konkursit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.90/2023 të datës 16.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pretendon së e njëjta ka ngarkuar me rastin e aplikimit të gjitha dokumentet e kërkuara sipas konkursit për grupin e pozitës *“Specialist të Shkencave Shoqërore-Inspektor i Arsimit” mirëpo sistemi nuk ka pranuar më shumë së një dokument, duke kërkuar qe ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar.*

Po nga provat e lëndës, Kolegji ka gjetur së Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, përkundër ankesës se ankueses kishte vazhduar me procedurën sipas konkursit të jashtëm me numër reference RN00010341, me ç’rast përmes njoftimit të datës 15.02.2023 ka bërë anulimin e konkursit për grupin e pozitës *“Specialist të Shkencave Shoqërore-Inspektor i Arsimit”*, kurse në përgjigje të kërkesës së Këshillit, përmes emailit të datës 03.03.2023, ka informuar Kolegjin se , citoj *“Sipas kërkesës suaj, ju njoftojmë se anulimi i konkursit për grupin Specialist të Shkencave Shoqërore....., ka ndodhur për shkak të gabimeve përmbajtjesore në kriteret e konkursit, për këtë arsye është parë e nevojshme të anulohet kjo procedurë”*.

Kolegji i Këshillit thekson faktin së kundër Njoftimit të datës 15.02.2023 për anulim të konkursit të jashtëm me numër reference RN00010341, për grupin e pozitës *“Specialist të Shkencave Shoqërore-Inspektor i Arsimit”*, kandidati me datë 22.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër A.nr.399/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli duke vendosur sipas ankesës A.Nr.399/2023 të datës 22.02.2023, ka shqyrtuar ligjshmërinë e anulimit të procedurës sipas Konkursit me numër reference RN00010341 dhe më Vendimin me numër A.nr.399/2023 të datës 15.03.2023 ka refuzuar ankesën me numër A.nr.399/2023 të datës 22.02.2023, duke lënë në fuqi Njoftimin e datës 15.02.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pasi që në vlerësimin e Këshillit, procedura e zhvilluar sipas konkursit me numër reference RN00010341 është përfshirë me shkelje procedurale dhe materiale, kështu që anulimi i kësaj procedurë është konsideruar i bazuar dhe i ligjshëm.

Andaj, duke qenë së objekti i ankesës A.nr.326/2023 të datës 07.02.2022 ka të bëjë me procedurën e konkursit me numër reference RN00010341, për grupin e pozitës *“Specialist të Shkencave Shoqërore-Inspektor i Arsimit”*, e cila procedurë është anuluar nga njësia përgjegjëse dhe meqenëse Këshilli me vendim meritore ka lënë në fuqi njoftimin për anulim të datës 15.02.2023, Kolegji konstaton së objekti i ankesës A.nr.326/2023 është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje, dhe si rrjedhojë në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot, vendosi që të përfundoj procedimin administrativ i filluar sipas ankesës së ankueses*




Përmbledhur si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësor për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQËSOR PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.326/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuseses
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së;